

**ILIR KALEMAJ**

**RIKRIJIMI I MEMORIES HISTORIKE NË RASTIN SERB:  
A MUNDEN PROCESSET E “RIMEMORIZIMIT”  
TË KRIJOJNË NJË IDENTITET TË RI?**

*“Të harruarit, ose të kujtuarit fals të historisë është një element esencial në (ri)krijimin e një kombi, dhe, kjo është arsyeja se pse avancimi i studimeve historike shpesh përbën një rrezik për ndjenjat kombëtare”.*

*Ernest Renan*

**Hyrje**

Kjo ese trajton një qasje teorike që parasheh një lidhje të ndërthortë mes historisë dhe memories historike, duke u bazuar veçanërisht në librat e historianit të madh francez Pierre Nora, dishepullit të tij, Jacques Le Goff, dhe Friedrich Kratchowil. Duke iu referuar kryesisht rastit serb, në punim janë analizuar aspekte të rindërtimit të memories kolektive kryesisht me qëllime manipulative, që sidomos në fund të viteve 80-të synuan sendërtimin e një identiteti të ri kombëtar me qëllim konfigurimin e realiteteve të reja politike. Pra, ndiqet një qasje kryesisht instrumentaliste që nga njëra anë studion efektet e manipulimit të historisë për t'i shërbyer interesave të caktuara, të cilat në rastin konkret kanë për bazë kryesisht prirje nacionaliste, ndërsa nga ana tjetër studiohet roli i metamorfozës që pëson identiteti kombëtar i një vendi dhe mënyra e perceptimit të tij në mënyrë kolektive në kapërcyelle të tillë historikë, si fundi i një epike dhe lindja e një tjetre.

Kontributi që ky punim ofron është kësajsoj i dyanshëm dhe shtrihet si në lëmin teorik, duke u bazuar kryesisht te Nora, por duke shkuar përtej një përsëritjeje mekanike të tezave që ai shtron në tre volumet enciklopedike: “Territori i memories: të rimenduarit e të kaluarës së Francës,” dhe duke e ndërlidhur me një realitet krejt tjetër, siç është ai serb në fund të katër dekadave komuniste. Në të hidhet dritë mbi disa nga zhvillimet kryesore që brenda një kohe shumë të shkurtër ndryshuan ligjërimin dominant të internacionalizmit proletar në nacionalizmin sektar dhe të skajshëm në republikën Serbe, gjë që më pas krijoi klimën për nxitje të irredentizmit shtetëror në Kroaci (Krajina), apo në Bosnje,

nëpërmjet krijimit të republikës surrogate të “Republika Srbska”, si dhe çoi në spastrimin etnik ndaj shqiptarëve të Kosovës jo më larg se një dekadë më parë. Pjesa e parë e këtij punimi analizon disa konsiderime teorike për historinë dhe memoriën kolektive të një kombi, të cilat dallojnë por edhe ndërliken e ndërveprojnë me njëra tjetrën për t'i dhënë formë një identiteti në ndryshim e sipër.

Ndërsa pjesa e dytë i referohet sidomos rastit serb dhe synon që nëpërmjet disa të dhënave empirike, përgjithësisht të pranueshme, të ravijëzojë disa elementë që qartësisht e identifikojnë këtë rast me një manipulim të memories dhe ndërjegjes kolektive çka çoi drejt një manipulimi të historisë së shkruar, ku vitet e federalizmit jugosllav, pavarësisht privilegjeve që u ofruan serbëve, të cilët zinin vendet kryesore në ushtri, administratë etj., të përshkruheshin si vite diskriminimi të tyre dhe si një padrejtësi historike që duhej korrigjuar. Këtë vizion të mbrapshtë të të kuptuarit të historisë, e jep më së miri studiuesi Ivan Čolović kur shkruan se “autoritetet në Serbi për vite me radhë kanë ndërtuar legjitimitetin dhe popullaritetin e tyre në politikën e rigjallërimit të miteve të së kaluarës, në slogane rreth realizimit final të aspiratave “shekullore” dhe “historike” të popullit Serb.”<sup>1</sup> Në mbyllje ravijëzohen edhe njëherë idetë kryesore të parashtruara në këtë ese dhe nxirren përfundime epistemologjike në lidhje me temën në fjalë.

### **Historia, memoria dhe identiteti: konsiderime teorike**

Pjesa më e madhe e shpjegimeve që janë ofruar për rritjen e beftë të nivelit të nacionalizmit të skajshëm serb që çoi drejt shpërbërjes së Jugosllavisë, janë të përqendruara rreth lidhjes shkakësore të ngjarjeve, duke u përpjekur të gjejnë një justifikim se përse gjërat rrodhën ashtu siç rrodhën. Por nëse perifrashojmë Kratochwil, një kombinim i “të njohurit ‘çfarë’ me të njohurin ‘si’, ”<sup>2</sup> mund të na jepet një kuptim më i thelluar i të kuptuarit, përtej një analize shkakësore simpliste, sesi nacionalizmi

---

<sup>1</sup> Ivan Čolović, *Politics of Identity in Serbia*, New York: “New York University Press”, 2002, f. 37.

<sup>2</sup> Shih për shembull: Friedrich Kratochwil, “History, Action and Identity: Revisiting the ‘Second’ Great Debate and Assessing its Importance for Social Theory”, *European Journal of International Relations*, SAGE Publications and ECPR-European Consortium for Political Research, Vol. 12 (1), 2006, f. 7.

zëvendësoi komunizmin si ligjërimi kryesor në jetën politike dhe publike. Një narracion interpretativ, specifikisht i interesuar me bashkëveprimin ndërmjet memories, historisë dhe identitetit (kombëtar) është më i përshtatshëm për të ndjekur rrjedhën kronologjike dhe dinamikat e një ligjërimi që lejojoi të katapultohej rastësisht në dominues, në zbrazëtinë që la zvetërimi dhe asgjësimi pothuajse i menjëhershëm i diskutit shterpë komunist. Ky i fundit, i përqendruar rreth një internacionalizmi ireal, pa vetveten të shembej bashkë me vdekjen e Josip Broz Titos, inspiruesit të jugosllavizmit artificial. Pak vite kaluan dhe u dukën efektet e kalbjes së një regjimi të tejkaluar dhe të imponuar mbi veçoritë e kulturave kombëtare. Fillimisht u vunë në lëvizje shqiptarët me demonstratat e tyre paqësore dhe lëvizjen studentore-qytetare për liri dhe më pas u abuzua nga serbët të cilët jo vetëm shtypën brutalisht këto protesta, por filluan të artikulojnë teza të një shtypjeje dhe diskriminimi të serbëve në federatë.<sup>3</sup>

Është me rëndësi që trajektorja historike të studiohet dhe të analizohet në mënyrë kritike. Kjo duhet bërë për t'u kuptuar marrëdhënia midis të dhënave historike holistike dhe memorieve individuale dhe kolektive, pasi ato shpesh ndodhen të mbuluara nga 'pluhuri' i historisë, dhe 'rizbulohen' në një moment të caktuar duke u instrumentalizuar nga liderë politikë apo segmente të caktuar shoqërorë. Në volumnin e tij të parë të historisë së Francës, një enciklopedi që e vendos autorin përkrah korifenjve të historiografisë botërore, Pierre Nora flet për historinë si "as ringjallje, as rikonstituim dhe as rindërtim apo përfaqësim, por në kuptimin më të fortë të fjalës, si "rikujtesë" (rememoration) - një histori që është e interesuar në memorien kolektive jo si kujtim i dëkajave të

---

<sup>3</sup> Memorandumi i vitit 1986 i autorizuar nga Akademia Serbe e Shkencave dhe Arteve dhe i shkruar nga një grup akademikësh, midis të cilëve dhe ata që kishin qenë për vite me rradhë të marginalizuar nga klani i Titos, jep një tablo të plotë të këtyre tezave. Për një shikim më në detaje të Memorandumit dhe efektin e tij në axhendën politike serbe shih *inter alia*: Tim Judah, *The Serbs: History, Myth and the Destruction of Yugoslavia*, New Haven: "Yale University Press", 1997, f. 160; Stuart J. Kaufman, *Modern Hatreds: The Symbolic Politics of Ethnic War* [Urrejtje Moderne: Politikat Simbolike të Luftës Etnike], Ithaca and London: "Cornell University Press", 2001, f.179; Norman M. Naimark and Holly Case (eds.), *Yugoslavia and Its Historians: Understanding the Balkan Wars of the 1990s* [Jugosllavia dhe historianët e saj: Të kuptuarit e Luftërave Ballkanike të viteve 90-të], Stanford: "Stanford University Press", 2003, f.174-175; Carole Roger, *The Breakup of Yugoslavia and its Aftermath* [Shpërbërja e Jugosllavisë dhe historia që vijoi], London: "Greenwood Press", 2004, f.16-17.

kaluar por si një ‘gjurmë’ e së kaluarës në të tashmen: “histori e shkallës së dytë”.<sup>4</sup> Për Norën, të kuptuarit sesi aktet dhe praktiket përkujtimore ndihmojnë në sendërtimin e një memorie publike është shumë e rëndësishme për të lidhur eksperiencat private me botëkuptimin kolektiv të historisë.

Ideja e historisë, sikundër edhe e memories, është ngushtësisht e lidhur me atë të kombit, ose më ekzaktësisht me atë të kombit-shtet. Ky i dyti nuk mund të ekzistojë pa të parin. Ernest Renan, historiani i njohur francez e ka përcaktuar kombin bazuar në dy shtylla: “të kenë bërë gjëra të mëdha së bashku” dhe “të duan të bëjnë të tjera”<sup>5</sup> ose si e përshkruan Nora: “kombi si trashëgimi dhe kombi si projekt.”<sup>6</sup> Diferenca ndërmjet Renan-it dhe Nora-s është se ndërsa Renan i sheh ato si dy pjesë të padallueshme nga njëra-tjetra dhe që të dyja janë tipare të pazëvendësueshme të kombit, Nora flet për ndarjen mes tyre. Që këtej, mund të arrijmë në konkluzionin se cila është diferenca kryesore mes historisë dhe memories. Historia është kronologjike, e pranuar gjerësisht dhe e ‘bekuar’ zyrtarisht e një varianti zyrtar sesi gjërat kanë evoluar natyrshëm, me një progresion linear dhe të lëmuar, ndërsa memoria ka më shumë përthyerje dhe është e ndikuar nga progresi i të kuptuarit të identiteteve kolektive. Sikundër sugjeron Kratochwil, identitetet kolektive janë më lehtësisht të ri-përcaktueshme sesa ato individuale, të cilat janë një pjesë e pandarë e vetvetes dhe gjithçkaje që lidhet me të. Ose e artikuluar ndryshe, nëse ndryshimi i identiteteve kolektive shpeshherë është një domosdoshmëri për përshtatje, transformimi radikal i identiteteve individuale mund të jetë katastrofal. Kjo mund të shpjegojë pse politikanët shpesh iu apelojnë identiteteve kolektive (të cilat janë të ndikuara nga ideologjia etj), sesa të përpiqen të ndikojnë dikë të ndryshojë disa nga bindjet e tija më të thella, të cilat mund të jenë në themel të personalitetit të tij apo saj.

---

<sup>4</sup> Pierre Nora, “From Lieux de mémoire to Realms of Memory”, In *Realms of Memory: Rethinking the French Past, Vol. I: Conflicts and Divisions*, Edited by Pierre Nora, New York: “Columbia University Press”, 1996, f. xxiv.

<sup>5</sup> Ernest Renan, *Qu’est-ce qu’une nation? Et autres textes politiques*, Paris: “Presses-Pocket”, 1992, f. 2.

<sup>6</sup> Pierre Nora, “Introduction to Realms of Memory, Vol. III”, In *Realms of Memory: Rethinking the French Past, Volume III: Symbols*, New York: “Columbia University Press”, 1998, f. 634.

Maurice Halbwachs nga ana tjetër investigon sesi memoriet dhe identitetet individuale mund të shërbejnë si instrumente me anë të cilave “memoriet kolektive ri-kompozojnë një imazh të së kaluarës të lidhur gjatë secilës epokë me idetë dominuese të shoqërisë [në atë moment të dhënë të kohës]”.<sup>7</sup> Por duke iu kthyer idesë së diferencës mes historisë dhe memories dhe sesi ato lidhen me idenë e kombit, na duhet të nënvizojmë se megjithëse ato mund të duken si të ndërlidhura dhe që konstituojnë njëra-tjetrën, ndryshimi mbetet. Duke iu referuar kombit historik, Nora shkruan që:

Vende specifike, institucione të paracaktuara, data të fiksuara, monumente të klasifikuara dhe ceremoni rituale për të treguar historinë dhe imazhin e tij (kombit historik-I.K.), ndërtojnë një spektakël dhe përkujojnë të kaluarën... Kombi memorial bën të kundërtën. Gjithë hapësira është e mbushur me gjurmë të një identiteti virtual dhe çdo gjëje në të tashmen i është dhënë një dimension shtesë që shtrihet në të shkuarën. Çfarë ka qenë njëherë e një kohë e perceptuar si pafajësisht e paraqitur në terma hapësinorë, tani na shfaqet dhe kuptohet si e paraqitur në akse kohorë (Nora, 1998: 636).

Por sikundër na e bën me dije autori, memoria kombëtare ka nevojë për një fragment të skeletit të kombit<sup>8</sup>, një thyerje të të kuptuarit të historisë sipas narracionit predominues zyrtar, në mënyrë që të prezantojë vetveten dhe t'i japë formë dhe kuptim kuptimit të ngjarjeve të kaluara dhe të tashme.

Dhe kur ky skelet historik thyhet dhe ka nevojë për ri-krijim të identitetit kolektiv, “modaliteti i të kujtuarit” sikundër Kratochwil shprehet, merr kuptim të ri dhe i jep formë të shkuarës sipas këndvështrimit të së tashmes. “Është problemi i tanishëm që i jep formë dhe kuptim të kaluarës dhe përcakton çfarë është me vlerë për t'u kujtuar”<sup>9</sup> dhe jo e anasjella, ku një histori e ‘ngurtë’ dikton të tashmen në një mënyrë vendimtare. Kjo është ajo çka në gjuhën e Norës quhet *vende te memorizimit*, ku sjellja ndaj së shkuarës dhe ndryshimet brendapërbrenda asaj sjelljeje, përbëjnë thelbin e përkufizimit që jep

<sup>7</sup> Maria Bucur, “Edifices of the Past: War Memorials and Heroes in Twentieth-century Romania”, In Maria Todorova ed., *Balkan Identities: Nation and Memory*, New York: “New York University Press”, 2004, f. 159.

<sup>8</sup> P. Nora, “Introduction to Realms ...”, f. 636.

<sup>9</sup> F. Kratochwil, “History, Action...”, f.11.

Nora.<sup>10</sup> Lawrence Kritzman në parathënien e tij te volumi i parë i Norës, shkruan se “të ricikluarit e njohurisë nëpërmjet asosacioneve dhe përfaqësimit të ri simbolik,”<sup>11</sup> krijon kushtet për zhvillimin e një metamorfozë të tillë. Ai shton se fusha e memories bëhet kaq fort e identifikuar me identitetin kombëtar sa mund të shndërrohet në një ‘shplarje truri’ për brezat e ardhshëm, të cilët përmes procesesh përsëritjeje tentojnë jo vetëm të përziejnë, por gjithashtu të japin njohur për mitet sipas dëshirave të tyre.<sup>12</sup>

Përfaqësimi simbolik është i rëndësishëm këtu, sepse mund të shihet si një procedurë që ndihmon në shkrijen e këtyre dëshirave (kolektive) në mite kulturorë, ndërkohë që i përkthejnë ato në gjuhën më të thjeshtë (dhe popullore) të mundshme, në mënyrë që gjithkush të ketë një shije të kësaj historie të ‘gjallë’. Ndonjëherë manipulimet simbolike të papërcaktuara janë të nevojshëm të justifikojnë praninë e një ideologjie të re. Më vonë, duke përsëritur vazhdimisht këto eksperiencat të ‘ndjera’ dhe të ‘gjalla’, nëpërmjet riteve të përsëritjes, ato gradualisht ‘memorizohen’ dhe kalojnë në memorjen kolektive. Përsëritja, shkruan Nora, duke perifrazuar Volterin “mbi të gjitha është ajo çka dallon përkujtimin nga celebrimi.”

### **Manipulimi i memories historike në rastin serb**

Në rastin e Serbisë, katalizatorë shoqërorë, të tillë si një pjesë e intelektualëve të margjinalizuar gjatë regjimit komunist, Kisha Ortodokse që mori përsipër flamurin e nacionalizmit të skajshëm apo grupime të tjera që përfshinin diasporën, grupet e krimit të organizuar të lidhura ngushtë me forcat e sigurimit dhe administratës shtetërore, krijuan mundësinë që nga njëra anë të krijonin një klimë të re ideologjike, ku të predominonte mendimi publik se serbët e kishin pësuar më tepër nga gjithë të tjerët nga sistemi federal dhe nga ana tjetër, të nxisnin politika shtetërore serbomadhe shoviniste dhe irredentiste që kulminuan me luftërat në Kroaci, Bosnje-Herzegovinë dhe Kosovë.

<sup>10</sup> P. Nora, “From Lieux de mémoire ...”, f. XVI.

<sup>11</sup> Lawrence D. Kritzman, “In Remembrance of Things French”, In *Realms of Memory: Rethinking the French Past, Vol.I: Conflicts and Divisions*, Edited by Pierre Nora, New York: “Columbia University Press”, 1996, f. XIII.

<sup>12</sup> *Po aty.*

Intelektualët, siç e theksuam edhe më sipër, shpesh kanë qenë në avantgardë të ndryshimeve shoqërore, prijës të debatit publik dhe nxitës të politikave shtetërore. Gjithsesi është vështirë të përkufizosh nëse gjithmonë ka qenë një “klasë e re” sipas përcaktimit të Machajskit apo “shtresë [e rëndomtë] burokratike” sipas atij të Trotskyt.<sup>13</sup> Rasti i Jugosllavisë, ku një pjesë e mirë intelektualësh të marginalizuar, si rasti i atyre të rrugës *Simina 9a* në Beograd,<sup>14</sup> si për shembull Čosić, Mihiz apo Popović apo pseudo-‘patriotëve’ si Čubrilović që kish shërbyer si për disa dekada nën Titon, përpara se të ‘rikujtohej’ për të qënurit një nacionalist i skajshëm, siç kishte qenë dikur në të ri të vet kur kishte firmosur dy memoradume për spastrimin e shqiptarëve, është veçanërisht interesant. Në një vorbull të gjerë përfshiheshin nacionalistë të sinqertë, ndonëse radikalë si Mihizi apo Popović që në fund të jetës së tyre nuk i flisnin më me gojë ‘tradhtarit’ Čosić që kishte ndërruar disa herë degë apo si rasti i Čubrilović, që ndryshoi disa herë kurs gjatë jetës dhe veprimtarisë së tij, duke u kthyer nga nacionalist ekstrem në një burokrat në sistemin komunist e më pas në një nacionalist të ‘rilindur’.

Pra, me një fjalë ata nacionalistë serbë që në vitin 1985 hartuan dhe firmosën Memoradumin famëkeq të Akademisë së Shkencave dhe Arteve që u dekonspirua dhe u publikua në shtyp një vit më vonë, duke dhënë dhe sinjalin e parë të një Jugosllavie që ishte e destinuar të shkonte drejt fundit të saj të natyrshëm, nuk ishin një trup politik i vetëm që përfaqësonte kohezion dhe unitet mendimi. Përkundrazi, ndonëse i bashkonte kauza nacionaliste dhe pretendimi se gjërat po shkonin keq për serbët në një federatë sipas tyre asimetrike me Serbinë, ata varionin shumë në bindje, formim, ideal apo përkushtim. Disa ishin oportunistë të thekur që përfunduan dhe në majat e pushtetit Milloshevician, disa vdiqën në varfëri, të braktisur dhe me shpirt të helmuar dhe të tradhtuar në idealin e tyre (sado i remë ky i fundit). Megjithatë, cilido ishte fundi i tyre, jo vetëm ai nuk mund të quhet kurrsesi një fund i lumtur, por mbi të gjitha hodhën poshtë edhe ato vlera skolastike apo formim akademik që mund të kishin. Kjo vlen jo vetëm për ata intelektualë të dështuar serbë

---

<sup>13</sup> András Bozóki, “Theoretical Interpretations of Elite Change in East Central Europe”, në Mattei Dógan (ed.), *Elite Configurations at the Apex of Power*, Leiden-Boston: “Brill”, 2003, f.219.

<sup>14</sup> Nick. Miller, *The Nonconformists: Culture, Politics, and Nationalism in a Serbian Intellectual Circle, 1944-1991*, Budapest: “Central European University”, 2007, f.5.

që jetonin akoma me mitet e shekullit të XIII, por edhe për ata që i shërbyen si lakenj pushtetarëve të tipit Milloshević, që siç shkruan autorja e mirënjohur Sabrina Ramet, e panë Miloshević si mishërimin natyral të ëndrrës së tyre për një Princ Lazar të ri.

Aq i turpshëm ishte ky shërbim i tyre sa kur njëri syresh dhe pikërisht Dobrica Ćosić, kur kërkoi sërish të ndërronte krahë dhe t'i bashkangjitej lëvizjes OTPOR, të drejtuar asokohe nga Xhinxhiq, ishte kaq i diskretituar sa fishkëllehej dhe përbuzej nga ato turma të cilave u kishte premtuar lavdinë e një Serbie të Madhe, ëndërr e ushqyer nga kohët e Stefan Dushanit. Ajo ëndërr i shpuri serbët drejt ngritjes së kulteve dhe miteve të rrejshme dhe që po i mban edhe sot larg qytetërimit evropian. Po aq e turpshme është edhe sjellja e pakuptimtë e intelektualëve të kalibrit të Comskit apo Horoëitz që me qëndrimet e tyre fashiste, të bazuara në pasione të çastit nuk arrijnë të artikulojnë qëndrime të qarta dhe të bazuara në racionalitet. Duke lënë veten të udhëhiqen ndaj fobi të pakuptimta dhe teori konspiracionale, si dhe duke i absolutizuar situatat pa bërë diferencim mes rastesh të ndryshme, ata tregojnë që niveli i tyre skollistik nuk mjafton për t'i quajtur intelektualë të mirëfilltë.

Po aq i rëndësishëm ka qenë edhe roli i ideve të vjetra që u rigjeneruan në një moment të caktuar në Serbi, për t'i dhënë udhë lindjes së një interpretimi rishtas të historisë, ndonëse thelbësisht irreal dhe të mbështetur në mitet e së kaluarës. Roli i ideve në rastin serb ka qenë kryesisht i lidhur me variacionet e idesë së Naçertanijes<sup>15</sup> që ka përbërë gjithmonë një karakteristikë të politikave të identitetit serb, duke filluar

---

<sup>15</sup> Programi zyrtar *Naçertanije*, i shkruajtur nga Ilija Garašanin, përmbante ndër të tjera territoret që shteti i ardhshëm serb duhet të përmbante dhe që përfshinin territore të perandorisë në dobësim e sipër Osmane, si: “Principata e Serbisë, Bosnjes, Herzegovinës, Malit të Zi dhe të ashtuquajturës Serbi e Vjetër (Kosova dhe Maqedonia).” Autori serb Millovoj Beslin shkruan ndër të tjera se “atë që Garašanini arriti ta realizonte në nivel shtetëror, Vuk Karaxhiqi, babai i gjuhës dhe alfabetit të Serbisë moderne e bëri në nivel kulturorolinguistik.” Për shembull duke iu referuar të gjithë sllavëve të jugut që flisnin dialektin “skokavski” si serbë, ai në këtë mënyrë përfshinte një përqindje të madhe të kroatëve si serbe, që indirekt i hapte rrugën pretendimeve irredentiste dhe shoviniste serbe të cilat më vonë u manifestuan në politika shtetërore. Shih për më tepër në lidhje me këtë pikë: Millivoj Beslin, “The Opening of the National Issue in the State of Serbia at the End of the 1960s and the Beginning of the 1970s,” në Petar Atanacković ed. *Nation as a Problem or Solution: Historical Revisionism in Serbia*, Novi Sad: “Futura publickaje”, 2008, f.27.

që nga mbretërimi i Stefan Mugoshës. Sikundër shkruan Tim Judah: “në pragun e shkatërrimit të lënë pas nga nacionalizmi bashkëkohor serb, Naçertanija është një gur themelor në kuptimin e zhvillimit të idesë nacionaliste; është dokumenti që sintetizon shekuj të ëndrrave serbe të ruajtura nga kisha dhe poemat epike dhe të formuluar në formën e një nacionalizmi modern.”<sup>16</sup>

Në kohëra më të afërta, ide të njëjta me Naçertanijen arritën të artikuloreshin nga fundi i viteve 80-të, kryesisht nga intelektualë të margjinalizuar, si Dobrica Ćosić dhe kulmuan me përmbledhjen e tyre në Memorandumin famëkeq të 1986-ës që përmendëm më lart, i cili shërbeu si shkollë e politikanëve nacionalistë dhe ekstremistë në vitet në vijim. Memorandumi, drafti i të cilit ju prezantua qeverisë serbe fillimisht në 1985-ën dhe arriti të zbulohet nga mediat në 1986-ën, bëri të mundur zhvendosjen ideologjike nga komunizmi jugosllav drejt nacionalizmit serb.<sup>17</sup> Memorandumi argumentonte që Serbët kanë qenë të viktimizuar gjatë historisë së tyre dhe kjo është kthyer në refrenin politik të ditës që atëherë. Ndërmjet të tjerash, Memorandumi theksonte që “ka pasur një konspiracion anti-Serb që ka shkaktuar gjenocid të popullsisë serbe në Kosovë,” dhe që “me përjashtim të periudhës së ekzistencës së regjimit të ustash në Kroaci, Serbët e Kroacisë nuk janë ndjerë asnjëherë më të kërcënuar sesa ata janë tani.”<sup>18</sup> Çfarë e bëri Memorandumin të besueshëm në sytë e publikut serb ishte “fakti që Akademia e respektuar bënte akuza të tilla...,”<sup>19</sup> duke i dhënë kësioj legjitimitet të menjëhershëm. Një nga figurat që shërbeu si burim inspirimi për përgatitjen e Memorandumit, duke marrë në të njëjtën kohë pjesë aktive në të, ishte Vasa Čubrilović, një nga nacionalistët më të vjetër dhe këmbëngulës serbë.<sup>20</sup> Čubrilović, një “konspirator i hershëm i vrasjes së Arkdukës Franc Ferdinand në

---

<sup>16</sup> Tim Judah, *The Serbs: History, Myth and the Destruction of Yugoslavia*, New Haven: “Yale University Press”, 1997, f. 59.

<sup>17</sup> Robert Stallaerts, “The Disintegration of the Yugoslav Intellectual Community”, në: *Secession, History and the Social Sciences*. Bruno Coppitiers and Michel Huyseune eds., Brussels: “VUB Brussels University Press”, 2002. Retrieved from: [poli.vub.ac.be/publi/orderbooks/secession/secession-05.pdf](http://poli.vub.ac.be/publi/orderbooks/secession/secession-05.pdf)

<sup>18</sup> S. J. Kaufman, *Modern Hatreds...*, p.179.

<sup>19</sup> *Po aty*.

<sup>20</sup> Philip J. Cohen, “The Complicity of Serbian Intellectuals”, në *This Time We Knew*, in Thomas Cushman and Stepjan G. Mestrovic (eds), New York: “New York University Press”, 1996, f. 39-40.

1914, ri-doli në skenë si këshilltar i qeverisë mbretërore jugosllave. Me këtë status, ai shkruajti memorandum zyrar të 1937-ës, ‘Dëbimi i Shqiptarëve,’ i cili citonte sukseset e Hitlerit dhe Stalinit në përndjekjen e çifutëve dhe të tjerëve si një shembull të denjë për t’u ndjekur nga serbët.”<sup>21</sup> Čubrilović pati disa funksione të rëndësishme qeveritare gjatë qeverisjes së Titos. çka dëshmon dhe për fleksibilitet të regjimit komunist të Titos.

Krahas Čubrilović-it, një antar tjetër i famshëm i Akademisë së Arteve dhe Shkencave të Serbisë, sikundër edhe disident i vonë i regjimit të Titos,<sup>22</sup> ishte Dobrica Čosić, i cili në vitet ‘60 ishte ndër të parët që artikuloi vuajtjen shekullore të serbëve dhe se “Serbët po shfrytëzoheshin dhe denigroheshin nga kombësitë e tjera jugosllave.”<sup>23</sup> Duke qenë se Čosić, sidomos nën ndikimin e miqve të vetë, Mihiz dhe Popović,<sup>24</sup> arriti të besonte se regjimi titoist ishte i predispozuar dhe në thelb diskriminativ kundër serbëve, Čosić “iu kthye theksimit për nevojën e bashkimit të kulturës serbe me kombin serb.”<sup>25</sup> Në këtë kontekst, ai ju bëri thirrje serbëve “të ngriheshin dhe shkatërronin shtetin shumë-kombësh jugosllav për të përmbushur qëllimin e vjetër historik dhe

<sup>21</sup> *Po aty.*

<sup>22</sup> Kjo për arsye se në fazën e parë të këtij regjimi, Čosić gëzonte gjithë privilegjet e mundshme të një komunizmi të devotshëm. Madje edhe kur u kthye në dissident, ndryshe nga fati i shumë kolegëve të tjerë, të cilët minimalisht provuan burgun apo internimin, Čosić-it nuk i hyri gjemb në këmbë.

<sup>23</sup> E cituar te Sabrina P. Ramet, *Balkan Babel*, Cambridge: “Westview Press”, 2002, f.19.

<sup>24</sup> Čosić, Popović dhe Mihiz qenë ndër disidentët e parë nacionalistë që dolën kundër politikave federaliste të Titos me tezën e diskriminimit serb nën këtë system. Për më tepër ata argumentuan se serbët ishin diskriminuar historikisht dhe janë humbësit e mëdhenj nga ngjarjet historike në Ballkan. Ajo që i bën paradoksale thëniet e tyre, është se ndërsa Popović dhe Mihiz besonin në këto ide dhe kanë qenë të marginalizuar që në fillim prej rregjimit të Titos, Čosić ishte një nga figurat udhëheqëse komuniste të kohës dhe ka gëzuar përkrahjen e Titos deri vonë. Për më tepër shih: Nicolas J. Miller, “The Nonconformists: Dobrica Čosić and Mica Popović Envision Serbia,” *Slavic Review*, Vol. 58, No. 3. (Autumn, 1999), f. 516, si dhe Nick Miller, *The Nonconformists: Culture, Politics, and Nationalism in a Serbian Intellectual Circle, 1944-1991*, Budapest: “Central European University”, 2007, f.47-52.

<sup>25</sup> Thomas A. Emmert, “A Crisis of Identity”, në: Norman M. Naimark and Holly Case (eds.) *Yugoslavia and Its Historians: Understanding the Balkan Wars of the 1990s*, Stanford: “Stanford University Press”, 2003, f. 174.

idealin kombëtar.”<sup>26</sup> Çfarë është veçanërisht e habitshme në këtë lloj memorandum, është fakti se megjithëse Serbët kanë qenë të përfaqësuar në mënyrë jo proporcionale në pozitat më të larta të pushtetit në Jugosllavinë federative, pra kanë pasur më shumë vende në krahasim me numrin e popullsisë nga kombet e tjera, përsëri intelektualë si Čubrilović dhe Čosić ankoheshin për diskriminim të padrejtë në dëm të serbëve. Por akoma më i çuditshëm është fakti se ata nuk u dënuan as me burgim, as me persekutim, me gjithë dallimet e thella nga thelbi internacionalist i marksizmit të kohës.<sup>27</sup> Pra thelbi i diskursit nacionalist, sidomos në qarqet intelektuale ka mbijetuar edhe gjatë kohës së Titos, por për shkak të mungesës së mediatizimit dhe monopolit të informacionit nga regjimi komunist, mundësia për të përhapur idetë e tyre nacionaliste dhe influencuar opinionin publik, ka qenë e kufizuar. Gjithëçka ndryshoi me vdekjen e Titos dhe me fillimin e një liberalizimi të mëtejshëm si rrjedhojë e paqëndrueshmërisë relative të një lidërshipi të fortë në krye të federatës jugosllave.

Memorandumi ishte sidomos i rëndësishëm në krijimin e një programi politik që projektonte “një Jugosllavi të dominuar nga Serbët që do përfshinte Serbinë, Malin e Zi, pjesën më të madhe të Bosnje-Hercegovinës, rajonet me popullsi serbe të Kroacisë, por do përjashtonte Maqedoninë, Slloveninë, pjesën më të madhe të Kroacisë dhe gjithashtu do t’i ofronte një pjesë të Bosnjes, Kroacisë si kompesim.”<sup>28</sup> Pra, Memorandumi krijoi një klimë të re politike, që filloi të influenconte vendimmarrjen politike të Beogradit zyrtar. Mbi të gjitha, i serviri një agjendë të gatshme Milošević-it, i cili bazoi retorikën e tij politike dhe karrierën e mëpasshme pikërisht në idetë e përpunuara në këtë dokument. Memorandumi arriti të krijojë “një rol që pret një lider, një program që pret një ekzekutor,” dhe pothuajse një vit më vonë, Milošević do arrinte të vinte në pushtet nëpërmjet këtij programi paraprak që atij iu servir gati. Ai arriti të shmangte nga drejtimi i partisë, protektorin e vet që nga koha kur kishte qenë një sekretar i thjeshtë rinie, Ivan Stambolić, duke

<sup>26</sup> Ph. J. Cohen, “The Complicity...”, f. 40.

<sup>27</sup> Kjo në fakt qe një anomali dhe jo rregull i përgjithshëm në Jugosllavinë e Titos. Mjafton të përmendim Gutmanin, kur ai shkruan se “edhe posedimi i një fjalori Kroat në vend të një Serbo-Kroat” ishte shkak i mjaftueshëm për burgim në Jugosllavi. Shih për më gjerë Roy Gutman, “Serb Author Lit Balkan Powder Keg,” *Newsday*, June 28, 1992, f.1.

<sup>28</sup> Stephen Saideman and R William Ayres, *For Kin or Country: Xenophobia, Nationalism and War*, f.56.

përdorur kartën e politikës etnike,<sup>29</sup> dhe fitoi me anë të një votimi të papritur dhe thujse spektakolar “një anëtar një votë”, drejtimin e partisë dhe shumë shpejt edhe të qeverisë.

Ndërkohë, sjellja e elitave serbe dhe segmenteve të ndryshëm të shoqërisë ishin duke u rritur përpjesëtimisht në mbështetje të politikave irredentiste serbe, në mbrojtje të bashkë-kombasve të tyre, jashtë kufijve zyrtarë, duke i dhënë Milošević-it një dritë jeshile për të ndjekur një politikë të jashtme edhe më agresive. Një shembull që ilustron veprimtarinë dhe qëllimet e një institucioni tjetër me peshë—krahast Akademisë që u përmend më sipër—është ai i Kishës Ortodokse Serbe. Në të njëjtën datë, 28 Qershor, 1989, tre ndodhi të shkëputura, por njëkohësisht të koordinuara dukshëm, lënë vend për një dyshim të bazuar në lidhje me rolin që ka luajtur ky institucion në nxitjen e irredentizmit serb. Ndodhia e parë ishte festa përkujtimore e 600 vjetorit të humbjes së serbëve në fushë-Kosovë në luftë me ushtrinë osmane, ku ishin grumbulluar mbi 100 mijë serbë. Gjithashtu në këtë datë, Milošević deklaroi para simpatizantëve serbë të Kosovës se “serbët gjatë historisë së tyre asnjëherë nuk kanë pushtuar apo shfrytëzuar të tjerët.”<sup>30</sup> Po në të njëjtën ditë, serbët e Krajinës kërkuan “një krahinë autonome.., me nxitjen e qeverisë serbe.”<sup>31</sup> Në të njëjtën ditë, Kisha Ortodokse Serbe:

shpalosi programin e saj zyrtar, i cili ishte një jehonë e Memorandumit të 1986-ës të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë, si edhe i dokumenteve zyrtarë të partisë komuniste dhe aparatit shtetëror jugosllav. Ky manifesto, i njohur si “*Propozim i Programit Kombëtar Serb*,” i thurte lavde vendimit të Serbisë që në mënyrë të njëanshme t’i jepte fund autonomisë së Vojvodinës dhe të Kosovës. Duke ritheksuar temën qendrore të memorandumit të Akademisë, dokumenti i Kishës portretizoi sipas tij një Serbi të nënshtruar dhe përgëzonte Slobodan Milošević-in që filloi të korrigjonte padrejtësitë historike ndaj serbëve.<sup>32</sup>

Megjithëse mund të duket spekulante, është e pamundur që të tre këto ngjarje, në dukje të palidhura, por që u bënë publike në të njëjtën ditë, mos të jenë sinkronizuar më parë. Konvergjencia e tyre duket se ka qenë një përpjekje nga strata të ndryshme shoqërore për të kanalizuar pakënaqësitë

<sup>29</sup> Horowitz e quan këtë proces ‘ethnic outbidding’, pra mundja e kundërshtarit politik duke përdorur më fortë kartën etnike.

<sup>30</sup> Ph. J. Cohen, “The Complicity...”, f. 41.

<sup>31</sup> *Po aty*.

<sup>32</sup> *Po aty*.

popullore drejt politikave agresive në drejtim të ‘çështjes kombëtare’. Liderë politikë, si Milošević në mënyrë diabolike më pas i instrumentalizuan në favor të tyre këto ide dhe i kthyen në program zyrtar të qeverisjes së tyre.

Roli i Kishës Ortodokse në fillim të viteve ‘90-të ishte qendror. Pavarësisht tonit nacionalist që Kisha ka artikuluar herë pas here gjatë historisë së saj, dekadat e gjata nën komunizmin, ndihmuan në krijimin e një klime anti-klerikale që e neutralizuan pothuajse rolin e Kishës. Kisha Ortodokse gjatë komunizmit ishte në përpjekje për mbijetesë dhe as që mund të mendoj të influenconte vendimmarrjet zyrtare. Por në fillim të viteve ‘90, serbët “të udhëhequr nga një Kishë Ortodokse Serbe e vëmendshme dhe nga intelektualët e saj, u nxitën që të vazhdonin të ndiqnin ... epikën me epiqendër Kosovën.”<sup>33</sup> Sikundër Thomas Emmert nënvizon:

Duke përdorur krizën në Kosovë, si një temë për rigjenerimin e saj si forcë efektive në shoqërinë serbe, Kisha prezantoi vetveten si një mbrojtëse e serbëve të Kosovës, duke rivizituar ‘martirizimin’ e Serbëve në Luftën e Dytë Botërore dhe së fundmi ndihmoi në shpërbërjen e Jugosllavisë dhe krijimin e Serbisë së Madhe.<sup>34</sup>

E parë në këtë dritë, Kisha krijoi një ‘strukturë diskursi oportune’,<sup>35</sup> që e ndihmoi atë të transferonte debatin nga çështjet ekonomike drejt atyre etnike. Fokusi kryesor i Kishës, filloi të bëhej një “ri-interpretim i historisë së Serbisë me terma të vuajtjes, shfrytëzimit, dhimbjes dhe

<sup>33</sup> Th. A. Emmert, “A Crisis...”, f. 173.

<sup>34</sup> *Po aty*.

<sup>35</sup> Erin K. Jenne e ka përkufizuar këtë shprehje si “struktura që kanë vazhdimësi, përputhshmëri dhe janë të adaptueshme ndaj një sërë ambjentesh, dhe që informojnë jo vetëm format legjitime të organizimit politik, por gjithashtu mjetet me të cilat këta ‘aktorë’ mund të ndjekin ‘qëllimet’ e tyre.” Shih për më tepër: Erin K. Jenne. *Ethnic bargaining: the paradox of minority empowerment*. Ithaca: Cornell University Press, 2007. Kuptimi që merr kjo lloj strukture në kontekstin e këtij punimi është në fakt disi i ndryshëm. Përdorimi i tij këtu bëhet për t’ju referuar krijimit të një strukture totalisht të re që krijon mundësi për institucione të tilla si Kisha Ortodokse, për të kapur momentin dhe dhënë formë apo trajtë ligjërimit politik, sidomos në lidhje me irredentizmin, i cili na intereson veçanërisht këtu. Politikanët rrjedhimisht janë në njëfarë mënyre të ‘detyruar’ që të veprojnë në përputhje me këtë ligjërimit shoqëror të ri dhe ta adaptojnë atë për t’iu shërbyer interesave të tyre elektorale.

drejtësisë.”<sup>36</sup> Pra Kisha, nëpërmjet ‘diversionit ideologjik’ bëri të mundur ri-katapultimin e saj si një faktor ndikues me peshë në shoqërinë serbe dhe njëkohësisht pa irredentizmin si mjetin më efektiv për stabilitetin e brendshëm.<sup>37</sup>

Për shembull, në 1987, memorandumimi u qarkullua në mbarë botën në komunitete emigrantësh serbë. Ai mobilizoi mbështetjen e tyre për qëllime nacionaliste e territoriale serbe, të cilat u justifikuan me pretendimet e viktimizimit serb në Jugosllavi, pa përmendur këtu vuajtjet e kombeve të tjerë nën diktatin serb. Në terma praktikë, memorandumimi ndihmoi në standartizimin e retorikës nga e cila emigrantët serbë do të mbronin Serbinë në rastin më të parë të fillimit të luftës.<sup>38</sup>

Theksoj se ekzistonin disa grupe te caktuara të mbyllura (cluster groups)<sup>39</sup> në brendësi të shoqërisë serbe të cilat tentuan të parashtronë interesat e tyre si të pandara nga ato të shtetit serb. Veçoj dy grupime të tilla: diaspora dhe grupet e mafies.<sup>40</sup> Këto grupe prodhuan një mbështetje kritike ndaj elitave të caktuara politike dhe përgjithësisht shtynë radikalët në politika të jashtme kritike. Diaspora serbe në fillim u tregua e përmbajtur, por në kontekstin e agresionit në Bosnje dhe Kroaci, u rigjallërua shpejt, vençanerisht në SHBA.<sup>41</sup> Brad K. Blitz jep një portret të gjallë dhe shumëngjyrësh të diasporës serbe dhe influencës së saj gjatë krijimit të lobimit. Edhe pse para agresionit serb në Jugosllavi diaspora

<sup>36</sup> Sabrina Ramet, “The Serbian Church and the Serbian Nation”, në *Beyond Yugoslavia: Politics, Economics, and Culture in a Shattered Community*, Boulder: “Westview Press”, 1995, f. 103.

<sup>37</sup> Ndërmjet disa hapave konkretë që Kisha ndërmori gjatë kësaj periudhe vlen të përmendet dhënia e medaljes ‘Majka Jugovica’ të cilësdo mamaje serbe që lindte katër apo më shumë fëmijë në Kosovë. Shih për më gjerë: Mark Almond, *Europe’s Backyard War*, London: “Mandarin Paperbacks”, 1994, f. 198.

<sup>38</sup> Ph.J. Cohen, “The Complicity...”, f. 39.

<sup>39</sup> Me këtë nënkuptoj grupime njerëzish që kishin interesa të përbashkëta dhe të lidhura me pushtetin, duke patur njëkohësisht dhe një *modus operandi* që i dallonte nga pjesa tjetër e shoqërisë.

<sup>40</sup> Grupet e mafias ishin shpesh ose pjesë integrale e pushtetit në Beograd (ku shpesh figurat qëndrore të krimit të organizuar serb, si punë të parë mund të kishin atë të punonjësit të sigurimit), ose kishin themeluar njëkohësisht lëvizje paramilitare dhe ndiqnin paralelisht edhe një jetë politike aktive. Rastet e famëkeqit Arkan, të ashtuquajturit ‘Legija’ apo Vojisllav Sheshelit janë vetëm disa prej këtyre figurave.

<sup>41</sup> Kjo sipas mendimit tim, ndodhi edhe për shkak të lehtësive që ofron sistemi amerikan në drejtim të lobimit nga grupe të mirorganizuara interesi.

serbe kishte një traditë të vakët në organizimet politike, ajo u organizua shpejt përreth senatorit Helen Delich Bentley.<sup>42</sup> Blitz përshkruan një paralelizëm ndërmjet radikalizmit të gjuhës së diasporës në njërin anë dhe rritjes së vrullshme të irredentizmit serb nga ana tjetër.

Ultranacionalizmi dhe ksenofobia e liderëve serbë në Pale (Bosnje) dhe Beograd u eksportua në SHBA nëpërmjet dy mbartësve kryesore: të parët ishin politikanët dhe emisarët që udhëtonin në Amerikën veriore dhe ish-Jugosllavinë. E dyta ishte kisha ortodokse serbe. Në fakt, diaspora serbe u mobilizua në komunitete të ngjashme dhe struktura institucionale, të cilat mobilizuan publikun serb pas agjendës nacionaliste të Millošević-it.<sup>43</sup>

Një element tjetër i rëndësishëm ishte rirforcimi i rolit të institucioneve ekzistuese mbi diasporën, si kisha ortodokse, duke bekuar aktivitetet e saj dhe duke legjitimuar regjimin nacionalist të Millošević-it. Kështu, “kisha ortodokse serbe dhe politika e saj në ish-Jugosllavi dhe në diasporë u gjendën të bashkuara.”<sup>44</sup> Krimi dhe sigurimi shtetëror shpesh herë ishin të lidhur gjatë periudhës së ‘regjimit të terrorit’ milloševiçian dhe ishte e vështirë t’i dalloje dhe t’i ndaje nga njëri tjetri. Pas vrasjes së kryeministrit Zoran Xhinxhiq, besohet se të ketë qenë banda e famshme e Zemunit, pushtetin e së cilës kryeministri ishte përpjekur ta thyente.<sup>45</sup> Ky klan kriminal “përfshiu shumë paramilitarë të cilët luftuan për ultranacionalistin Millošević në luftërat e Ballkanit, në Kroaci, në Bosnje e Kosovë.”<sup>46</sup> Atyre ju dha “një dore e lirë në trafikimin e drogës nga Millošević. Krimet dhe aktivitetet e tyre të paligjshme përfshijnë: rrëmbime, vrasje, kontrabandë njerëzish, armësh dhe cigaresh.”<sup>47</sup> Ata

<sup>42</sup> Kjo senatore e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në atë kohë, ishte njëkohësisht dhe liderja kryesore e diasporës serbe në SH.B.A. Shih për më tepër, Brad K. Blitz, “Serbia’s War Lobby,” në *This Time We Knew*, in Thomas Cushman and Stepan G. Mestrovic (eds), New York: “New York University Press”, 1996, f. 196.

<sup>43</sup> *Po aty*.

<sup>44</sup> *Po aty*, f. 202.

<sup>45</sup> Për më gjerë shih John Philips, “In Serbia, prime minister’s slaying triggers mafia roundup,” *The Christian Science Monitor*, March 25, 2003. <<http://www.csmonitor.com/2003/0325/p07s02-woeu.html>> (accessed April 3, 2007).

<sup>46</sup> *Po aty*.

<sup>47</sup> *Po aty*.

influencuan në masë politikën e Beogradit, duke angazhuar anëtarë të njohur të tyre në poste qeveritare si Arkan apo Legija, të cilët ishin pjesë e qeverisjes por ndërkohë punonin dhe për interesat e tyre. Me pak fjalë, pushteti i këtyre grupeve kriminale ishte i konsiderueshëm dhe ata ndiqnin lirisht interesat e tyre nën krahun e ngrohtë të shtetit. Ndodhi që interesat e tyre për të rritur fitimet prej veprimtarive ilegjitime i shkonin për shtat Millošević-it dhe elitave drejtuese, kështu që shpejt liderë të bandave kriminale si Arkan dhe Vojislav Šešelj u gjendën në pozita dominuese pushteti. Gjithsesi, lidhjet midis tyre nuk kanë qenë asnjëherë në vijë të drejtë, lineare. Millošević i përndoqi dhe i denoncoi vetëm atëherë kur krimet dhe masakrat e tyre u bënë tepër të dukshme dhe e vunë atë në pozitë të vështirë, sidomos para faktorit ndërkombëtar.<sup>48</sup>

Por, kur Millošević i frikësuar prej konsolidimit të këtyre grupeve të kriminit, të cilët në njëfarë mënyre e kufizonin pushtetin e tij duke u ligjëruar dhe vetëligjëruar, vendosi t'i jepte fund influencës së tyre duke i kërcënuar, ata e kthyen besnikërinë e tyre drejt opozitës duke i dhënë asaj një mbështetje të fuqishme.<sup>49</sup> Kur opozita erdhi në pushtet në vitin 2000 dhe u mundua t'u përgjigjej kërkesave të perëndimit për dorëzimin e kriminelëve të luftës si dhe fillimin e luftës kundër kriminit të organizuar, këta ish- oficerë ushtarakë të shndërruar në lordë krimesh i rezistuan egërsisht veprimeve të qeverisë, duke kërcënuar, frikësuar dhe madje duke vrarë figura të njohura politike si kryeministri serb Zoran Xhinxhiq. Gjithsesi, qeveria pasardhëse u mundua të merrte masa vendimtare kundër këtyre "lobeve të mundshëm të luftës,"<sup>50</sup> të cilët dikur konsideroheshin si aleatët kryesorë të Millošević-it, por më 12 mars vranë Xhinxhiqin në një përpjekje të dëshpëruar për të shkatërruar procesin e demokratizimit të vendit dhe politikën e bashkëpunimit me gjykatën e krimeve për ish-Jugosllavinë në Hagë. Fundi i ndikimit të

<sup>48</sup> Për një argument të ngjashëm shih gjithashtu Kaufman, 192.

<sup>49</sup> Shih ndërmjet të tjerësh, V. P. Gagnon, *The Myth of Ethnic War: Serbia and Croatia in the 1990s*, Ithaca: "Cornell University Press", 2004, f.130; Dragan Bujosevic and Ivan Radonavic, *The Fall of Milosevic: The October 5<sup>th</sup> Revolution*, New York: "Palgrave Macmillan", 2003, f. 27-30.

<sup>50</sup> Bojan Dimitrijevic and Daniel Sunter, "Serbia: Red Berets Disbanded", në *International War and Peace Reporting Balkans Crisis Report*, March 27, 2003.

[http://www.iwpr.net/index.pl?archive/bcr3/bcr3\\_200303\\_418\\_2\\_eng.txt](http://www.iwpr.net/index.pl?archive/bcr3/bcr3_200303_418_2_eng.txt)  
(aksesuar April 4, 2007).

drejtpërdrejtë të këtyre grupeve të interesit ka konciduar jo çuditërisht edhe me fundin e politikës irredentiste të Serbisë.

### **Mbyllje**

Ky punim u mundua të ravijëzonte disa këndvështrime teorike mes lidhjes së memorieve private dhe aty kolektive, si dhe mes konceptit përcaktues të historisë dhe historisë që transformohet nëpërmjet manipulimit të memories historike. Duke u bazuar kryesisht në veprën e historianit të njohur francez Pierre Nora dhe diskutimit të tij teorik për lidhjen e ndërsjellë mes historisë së shkruar dhe memories së ‘gjallë’, u fokusua në një analizë të rastit serb dhe transformimit të ligjësisimit dominant publik atje në vitet 1986-1991. Më konkretisht punimi synoi të trajtonte zëvendësimin pothuajse të menjëhershëm të ideologjisë komuniste dhe internacionalizmit proletar në sferën publike në fund të viteve ’80, çka u iniciua fillimisht me Memorandumin famëkeq serb të vitit 1986 me një nacionalizëm kallp deri në shovinizëm që lejoi më pas fillimin e një prej luftërave më të tmerrshme në historinë e Ballkanit dhe që natyrisht çoi në shpërbërjen e Jugosllavisë.

Përsa i përket manipulimit që iu bë identitetit në këtë kapërcyell historik mund të arrijmë në deduksionin logjik që ai u arrit të rikrijohej nëpërmjet proceseve të “rimemorizimit” duke shpikur armiq të jashtëm, mbrojtja ndaj të cilëve u kthye në domosdoshmëri kolektive, duke vënë theksin te ekluziviteti i kombit (nënkupto kombin serb-I.K.) apo duke nënvizuar autarkizmin prapanik përballë rrezikut të jashtëm. Pak a shumë, është një proces i njëjtë me atë që Umberto Eco shkruan në studimin e tij “Fashizmi i Përjetshëm”, ku ai shprehet se: “Kombi e sheh identitetin e tij vetëm përmes armiqve (të tij)”. Pa synuar se e kemi ezauruar këtë temë e cila është rrahur gjerë e gjatë nga historianë dhe politologë të ndryshëm, por e parë nga këndvështrime të ndryshme, qëllimi i këtij punimi ishte kryesisht hapja e një dritareje të re nga ku mund të analizohen tre procese sa të ndërlidhura, aq edhe të dallueshme nga njëri tjetri: historia zyrtare, memoria kolektive dhe procesi i formësimit të identitetit kombëtar dhe sesi këto mund të manipulohen lehtësisht nga politikanë, institucione apo grupe shoqërore të interesuara në momente të caktuara historike.

*S u m m a r y***THE RECREATION OF THE HISTORICAL MEMORY IN THE SERBIAN  
CASE: CAN THE PROCESSES OF "RIMEMORISATION" CREATE  
A NEW IDENTITY?**

The case of Serbia is taken into analyses, given that while it was the biggest state in the federation land whose rapid rise of nationalism and subsequently irredentism, which led to the breakup of Yugoslavia. Serbian sudden rise of nationalism and its active irredentist engagement in Bosnia that soon followed is somewhat overlooked, especially in an interpretive, historical context. Furthermore, as Jill Irvine has put it, among the post-Yugoslav states that engaged in intra-state fighting afterwards, "state-building has developed most extensively there" and this process of state-building as this paper argues, was largely based on revival of memories and 'living the past into the present'. The aim of this paper is to analyze the shaping of a new nationalist identity from the perspective of the recollection of past memories, mostly the ones from the pre-World war II period, which eventually led to the rise of a new discourse in post-communist Serbia and created the conditions for ethnic cleansing and other related phenomena that accompanied the first years of transitions.

The main question that this essay answers is how memories of pre-communist Serbia were brought into the public fora and came to be dominating the discourse of late 1980s, which in turn led to the rise of new nationalism and subsequent disintegration of Yugoslavia? Proxy questions that are related to this, are: how the new (nationalist) identity was shaped by these recollection of past memories? What role did the honoring of memory of the pre-communist period came to play in the aftermath of communism in Serbia? Finally and related, if were to paraphrase French historian Pierre Nora and adopt a narrow concept of its lieux de mémoire, what role did the commemoration processes, new emblems, anthems, mottoes, or institutions, as well as men, who make possible the creation of many of the means through which "memories are perpetuated" came to play in the aftermath of communism in Serbia and forging of the new identity?